



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
 VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-II-16-0009

A.Xh.,

Paditësitë

A.B.Xh.

A.BB.Xh.

A.BBB.Xh.

A.A.Xh., , Prizren

A.Sh.Xh. Prizren

përfaqësuar nga **Avokat**

kundër:

Të paditurat/Ankueset

1.KBI, Prizren

2.Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Agim Ramadani" nr.13, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke

vendosur sipas ankesës së të paditurave të paraqitur kundër Aktgjyimit të Gjykatës Komunale, Prizren C.nr. 267/2001 të datës 24.11.2009, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26/09/ 2019, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Ankesa e të paditurave aprovohet si e bazuar,
2. Anulohet, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, Prizren, C.nr. 267/2001 të datës 24.11.2009.
3. Lënda kthehet në rigjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së.
4. Kërkesa për caktimin e masës së sigurisë, kthehet në shkallë të parë të DHPGJS-së për vendosje.
5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 15 maj 2001, paditësit kanë dorëzuar pranë Gjykatës Komunale në Prizren një padi për anulimin e kontratës mbi shitblerjen e patundshmërisë në vlerë prej 150 DM. Paditësit në padi pohojnë se janë trashëgimtarë legal të të ndjerit A.Xh. nga Prizren i cili ka qenë pronar i pronës së kontestuar , ngastrës kadastrale nr.2, në vendin e quajtur me kulturë arë e klasës së III-të në sipërfaqe prej 0.70,00 ha e evidentuar sipas fletës poseduese nr. 213 KK K dhe ngastra kadastrale nr. 187/2 në vendin e quajtur K me kulturë arë e klasës së III-të në sipërfaqe prej 0.21,00 ha e evidentuar sipas fletës poseduese nr. 213 KK K. Paditësit kanë pohuar se paraardhësi i tyre A.Xh. nën kërcënim ka lidhur kontratën e shitblerjes së patundshmërisë me KBI , dhe pastaj e njëjta është vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Prizren me nr. Posl. Ov.nr. 2619/63 dt. 27.12.1963. Kontraktuesi A.Xh. ka vdekur me datë 23.01.2001. Paditësit kanë pohuar se pronat e tyre kanë kaluar në fondin e pronës shtetërore e më vonë në

sistemin Fusha e Prizrenit. Padiësit kishin kërkuar nga Gjykata Themelore në Prizren që të aprovet kërkesa e tyre, të vërtetohet se kontrata e cekur nr. Posl.Ov.nr. 2619/63 dt. 27.12.1963 e lidhur mes Xh.A. dhe KBI është e pabazë, të vërtetohet se padiësit janë trashëgimtarët legal të patundshmërisë ngastrës kadastrale nr.2, në vendin e quajtur me kulturë arë e klasës së III-të në sipërfaqe prej 0.70,00 ha e evidentuar sipas fletës poseduese nr. 213 KK K dhe ngastra kadastrale nr. 187/2 në vendin e quajtur K me kulturë arë e klasës së -III-të në sipërfaqe prej 0.21,00 ha e evidentuar sipas fletës poseduese nr. 213 KK K, si dhe të obligohet e paditura t`ia kthej pronat e kontestuara padiësve dhe ata lirisht të mund ti disponojnë ato. Padiësit ia ka bashkangjitur një çertifikatë nga Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren nr. 023/1153 dt. 11.05.2001 me të cilën shihet se pronat e cekura deri më 1953 kanë qenë në emër të A.Xh. pastaj në bazë të kontratës mbi shitblerjes 2619/63 dt. 27.12.1963 kanë kaluar në pronësi të KBI Prizren, çertifikatën e vdekjes së A.Xh. çertifikatat e lindjes së A.Xh., A.Xh., Raportin e ekspertit si dhe konstatimin e ekspertit.

Me datë 23 dhjetor 2003 padiësit A.Xh. dhe A.Xh., kanë dorëzuar edhe një parashtrësë pranë Gjykatës Komunale në Prizren me të cilën përfshijnë në padi edhe disa trashëgimtarë tjerë: A.Xh. B., A.Xh.Shabani, A.Xh.A., A.Xh.B. dhe B.Xh.

Ne shkresa të lëndës shihet se padiësit kanë dorëzuar Çertifikatën e vdekjes së B.Xh.A.(03.02.1920-28.09.2005), Aktvdekjen e Xh.A.(25.06.1906-05.01.2001), Çertifikatën e martesës së A. dhe B.Xh.A., çertifikatën e vdekjes së A.Xh. , çertifikatën e lindjes së A.Xh., A.A.Xh., A.A.A.Xh., A.Xh., A.Xh. dhe A.Xh., kontratën mbi shitblerjen e patundshmërisë nr.11647/835 dt.25.12.1963 mes A.Xh. dhe KBI Prizren e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren Posl.Ov.nr. 2619/63 dt. 27.12.1963, Çertifikatën nga Zyra Kadastrale Prizren për pronën nr. P-71813037-03338-0 ZK K, Çertifikatën nga Zyra Kadastrale Prizren për pronën nr. P-71813037-03340-0 (564 List. Pos.) ZK K, Çertifikatën nga Zyra Kadastrale Prizren për pronën nr. P-71813037-03339-0 (499), ZK K Çertifikatën nga Zyra Kadastrale Prizren për pronën nr. P-71813037-00226-0 (499), ZK K, Çertifikatën

nga Zyra Kadastrale Prizren për pronën nr. P-71813037-03315-0 (499 List. Pos) ZK K, Certifikatën nga Zyra Kadastrale Prizren për pronën nr. P-71813037-03314-0 (499) ZK K, Certifikatën nga Zyra Kadastrale Prizren për pronën nr. P-71813037-00222-0 (572 List. Pos.) ZK K.

Me datë 09 tetor 2007, paditësit kanë dorëzuar autorizimin e përfaqësuesit ligjor S.G., avokat nga Prizreni.

Me datë 07 nëntor 2007 NSH ka dorëzuar autorizimin e përfaqësuesit të saj F.H.

Sipas Raportit të Ekspertit të datës 22 nëntor 2007, lidhur me ngastrat kadastrale të kontestuara nga të dhënat e matjes të vitit 1952 del se parc. katastrale r. 2 me kulturë arë e kl të III-të në sipërfaqe prej 7000m² në vendin e quajtur "G" dhe parc. Katakstrale nr. 187/2 me kulturë arë e klasit të III-të në sipërfaqe prej 2100m², në vendin e quajtur Kevidentohej në listën poseduese nr. 213 Zk K në emër të A.B.Xh.

Në vitin 1963 me kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Leg.nr.2619/63 dt. 27.12.1963 A.Xh. tjetëron parcelat kadastrale, lëndore, nr. 2 dhe 187/2 KBI nga Prizreni. Eksperti konstaton se në bazë të dhënave Tahimetricke të matjes nga viti 1953 dhe llogaritjes së pikave mëgjeve për parcelat nr. 2 dhe 187/2, dhe bartjes së të njëjtëve në plane aerofotogrametike të incizimeve nga viti 1980 për ZK K konstaton se:

- se parc.kat.nr 2 të matjes detale sot gjendet në këto parcela:
- në pjesën e parc.kat.nr 3339 ZK K në sipërfaqe prej 6732 m² e cila është e evidentuar sipas list.podeduese nr 499 ZK K në emër të KBI , nga Prizreni
- në pjesë të parc. katastrale nr. 3338 ZK K në sipërfaqe prej 445 m², e cila është evidentuar sipas list.pos. nr. 499 ZK K në emër të PSH. PIK nga Prizreni.

Sipërfaqja e tërësishme e parc.kat. nr. 2 të matjes përshkruese prej 7177 m² pranë Shërbimit kadastral të paluajtshmërisë do të evidentohet si parc.kat. nr. 3339/2 ZK K. Dallimi në sipërfaqe prej 177 m² është në atë se të dhënat në

kontratë mbi shitblerjen janë të matjes përshkruese, derisa sipërfaqja e vërtetë dhe reale e parc.kat.nr. 2 është 7177 m², nga koordinatat e incizimit Tahimetrit të vitit 1953.

Ndërsa parcela kadastrale nr. 187/2 sot gjendet në këto parcela:

- në pjesën e parc.kat.nr. 222 ZK K në sipërfaqe prej 564 m² e cila është e evidentuar sipas list.pos.nr. 572 ZK K në emër të R.F.A.
- në pjesën e parc.kat.nr. 3314 në sipërfaqe prej 1185 m² e cila është e evidentuar sipas list.pos.nr. 499 ZK K në emër të PSH KBI nga Prizreni
- në pjesën e parc. Kat.nr. 3315 në sipërfaqe prej 914 m² e cila është e evidentuar sipas list.pos.nr. 499 ZK K në emër të PSH KBI nga Prizreni

Sipërfaqja e tërësishme e parc.kat.nr. 187/2 prej 2665 m² të matjes detale pranë Shërbimit për paluajtshmëri do të evidentohet si parc.kat.nr. 3314 Zk. Dallimi në sipërfaqe prej 565 m² është për atë se në kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë janë të matjes përshkruese derisa sipërfaqja e vërtetë dhe reale e parc.kat.nr. 187/2 është 2665 m² nga koordinata të pikave të mëgjes të incizimit Tahimetrik të vitit 1953.

Eksperti ka konstatuar se me identifikimin në vendin e ngjarjes është vërtetuar gjendja faktike si vijon, parcelat lëndore nr. 2 dhe 187/2 sot shfrytëzohen si arë dhe nuk janë në prodhimin e organizuar të KBI , në të njëjtat nuk ka të ndërtuara objekte ndërtimore dhe të mbjella të përhershme.

Parc.kat.nr. 3339/2 në sipërfaqe prej 7177 m² (matja përshkruese e parc.kat.nr.2) shfrytëzohet në kufi sipas skicës së lartë paraqitur:

-nga veriu 121.20m, nga jugu 79.90m, nga lindja prej thyerjes në thyerje në gjatësi të tërësishme prej 79.40m dhe nga perëndimi prej thyerjes në thyerje në gjatësi të tërësishme prej 110.80m.

-parc.kat.nr. 3314 në sipërfaqe prej 2665m² (matja përshkruese e parc.kat.nr.187/2) shfrytëzohet në kufi dhe atë nga veriu 123,40m, nga jugu 109.70m, nga lindja 37,30m dhe nga perëndimi 26,40m.

Me datë 24 nëntor 2009, Gjykata Komunale në Prizren merr Aktgjykim C.nr.267/01 me të cilin e aprovon kërkesë padinë e paditësve, vërteton se është nul kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë leg.nr. 2619/63 të vërtetuar nga Gjykata Komunale Prizren me datë 27.11.1963, obligon të paditurën KBI Prizren që paditësve t'ia dorëzoj në posedim paluajtshmëritë si vijojnë:

-parc.kat.nr. 3339 ZK K në sipërfaqe prej 0.67,32ha dhe një pjesë nga parc.kat.nr. 3338 në sipërfaqe prej 445 m² në sipërfaqe të tërësishme prej 0.17,77ha e cila sipërfaqe në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren është e evidentuar si parc.kat.nr. 3339/2 ,ZK K, në masë dhe kufi: nga veriu 121,20m, nga jugu 79,90m, nga lindja prej thyerjes në thyerje në gjatësi prej 79,40m dhe nga perëndimi prej thyerjes në thyerje në gjatësi të përgjithshme prej 110,80m.

-një pjesë nga parc.kat.nr. 3314 në sipërfaqe prej 0.11,85 ha, sipas list.pos.nr. 499 ZK K dhe një pjesë nga parc.kat.nr. 3315 në sipërfaqe prej 914 m² sipas lis.pos.nr.499 ZK K në sipërfaqe të tërësishme prej 0.26,65 ha e cila sipërfaqe në Drejtori për Gjeodezi në Prizren evidentohet si parc. kat.nr. 3314 ZK K në masë dhe kufi: nga veriu 74,01m nga jugu 89,91m nga lindja 37,30m nga perëndimi 26,40m, dhe që i padituri të obligohet ti pranojë dhe të lejojë që parcela e cekur katastrale nr. 339/2 ZK K në sipërfaqe prej 0.17,77ha dhe parc.kat.nr.3314 në sipërfaqe prej 0.26,65ha ZK K të regjistrohen në emër të paditësve nga 1/6 e pjesës ideale në Drejtorinë për gjeodezi dhe katastër në Prizren të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit.

Në arsyetimin e saj ligjor Gjykata Komunale ka konstatuar se i ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve N.Xh. dhe M.B. sepse ato përputhen në tërësi dhe e vërtetojnë faktin se kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë nuk ka qenë shprehje e vullnetit të lirë të shitësit por janë të lidhura me presion të bërë në shitësin nga ana e aktivistëve të cekur dhe si e tillë është absolutisht nul. Tutje

Gjykata Komunale konstaton se në bazë të nenit 8a të Ligjit mbi Qarkullimin e Paluajtshmërisë, janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e kontratës lëndore për shkak se është lidhur me dhunë dhe presion pa vullnet të lirë ,në kushtet kur nuk ka qenë e siguruar siguria e personave dhe e pasurisë, pasi që në kushte kur është lidhur i njëjti është absolutisht nul dhe nuk prodhon efekt juridik nga momenti i lidhjes së saj. Tutje konstaton se sipas dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore-Juridike pronari mundet me padi të kërkoj nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar individualisht, pra edhe të paluajtshmërisë ashtu që duhet të vërtetohet se sendi i cili kërkohet të kthehet është pronësi e tij dhe se gjendet në pushtet faktik të paditësit dhe e drejta në padi në këtë rast nuk vjetërohet. Me vërtetimin e nulitetit të kontratës së cekur lëndore janë aktivizuar të drejtat pronësore të pronarit të mëparshëm të parcelave lëndore, respektivisht të trashëgimtarëve të tij, paditësve, të cilët tani si pronar të kësaj paluajtshmërie pas vdekjes së paraardhësit të tyre tani të ndjerin A.B.Xh. në bazë të trashëgimisë kanë të drejtë të kërkojnë nga i padituri, në të cilin janë të evidentuara parcelat lëndore që ato të kthehen në posedim dhe që i padituri të lejojë që të njëjtat të regjistrohen në Drejtori për gjeodezi dhe kadastër në Prizren në emër të paditësve si bashkëpronar të njëjtë.

E paditura AKP-ja Aktgjykimin e cekur e ka pranuar me datë 16.06.2010, ndërsa KBI e ka pranuar me datë 15.06.2010.

Me datë 28 qershor 2010,e paditura AKP e dorëzon një ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr. 267/01 të datës 24 nëntor 2009.

E paditura në ankesë ka theksuar se Aktgjykimi i cekur i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave juridike procedurale nga neni 181.1 (a,b,c), 182 (e,n), 183 dhe 184 të LPK. Tutje thekson se Aktgjykimi i ankimuar nuk ka arsye mbi faktet vendimtare, ka kontradikta mes dispozitivit dhe arsyetimit, nuk shpjegon fare mbi bazën e cilave kushte e mbështet dispozitivin kur vendos ta anuloj kontratën etj. AKP pohon se në rastet kur përdoret shprehja nule, duhet paraprakisht të vërtetohet se veprimi i caktuar juridik e ka cenuar normën imperative, e në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk i ka

vërtetuar këto fakte dhe për këto arsye nuk mundet të konsiderohet si Aktgjykim i drejtë dhe i ligjshëm. AKP tutje pohon se anulimi i kontratës për shkak të mungesë së vullnetit eventual të palëve nëse ajo është e lidhur me presion mashtrim apo lajthim duhet të kërkohet në afatin subjektiv prej një viti nga dita e njohjes për arsyet e anulimit, apo më së largu deri në kalimin e afatit tre vjeçar nga dita e lidhjes së kontratës (neni 117 LMD), e në rastin konkret kemi të bëjmë me konvalidimin në heshtje të kontratës dhe kërkesa si e tillë është e parashkruar. AKP thekson se Gjykata vendimin e saj e ka mbështetur në nenin 8 a). të Ligjit për Qarkullimin e Patundshmërisë të GZ RSS nr 40/8, muaji shtator, e që ligji në fjalë nuk është i aplikueshëm në Kosovë, sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 për ligjin në fuqi në Kosovë. AKP kërkon nga Gjykata e Qarkut që të aprovon ankesën e AKP-së si të bazuar dhe ta prish Aktgjykimin e ankimuar dhe padinë e paditësve ta refuzon si të pabazuar.

Me datë 02 korrik 2010, e paditura KBI Lavërtaria-Blegtoria-Drejtoria Prizren gjithashtu ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren, për shkak të shkeljes esenciale të procedurës, aplikimit të gabuar të ligjit dhe vërtetimit të pasaktë dhe të paplotë të gjendjes faktike. Në ankesë e paditura thekson se aktgjykimi i shkallës së parë është i pakuptimtë, kontradiktor me vetën dhe si i tillë nuk mund të kuptohet në tërësi dhe se në çfarë bazë është sjellë. Tutje e paditura thekson se anulimi i kontratës nga shkalla e parë është bërë pa kurrfarë provash, dhe se dëshmitarët e dëgjuar nuk kanë qenë të bindshëm e as dëshmitë e tyre nuk mund të pranohen si autentike për këtë çështje. Gjithashtu e paditura pohon se ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë nuk bazohet në baza reale duke pasur parasysh se i njëjti nuk është materializuar me asgjë dhe se i njëjti bazohet në dëshmitë e fotografimit ajror, e cila ekspertizë bazohet në baza paushallë, dhe sipërfaqet e ngastrave që janë lëndë të kontestit nuk përputhen me faktet reale, respektivisht sipërfaqet nga kontrata për shitblerje, pasi që qëndrojnë numra të ri të ngastrave pa dhënë asnjë arsye se kur janë bërë ndryshimet dhe pse ka ardhur deri te këto ndryshime, duke lind dyshim se këta numra të ri nuk kanë të bëjnë me numrat e ngastrave nga kontrata. Gjithashtu e paditura thekson se në ekspertizën e ekspertit qëndron ngastra kadastrale nr. 222 ZK K në sipërfaqe

prej 564 m², e cila evidentohet si ngastër, nr. 572 ZK K, është e regjistruar në emër të R.F.A. nga fshati K e për këtë nuk është ofruar kurrfarë sqarimi se në çfarë baze kjo ngastër ka kaluar në atë emër. Në fund e paditura kërkon që të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë C.nr. 267/01 dt. 24.08.2009 dhe kërkesëpadia të hidhet poshtë si e pabazuar.

Me datë 15 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren shkresat e lëndës AC.nr. 462/2010 i referon në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për të vendosur lidhur me çështjen si gjykatë kompetente, dhe lënda në DHPGJS merr numrin SCA-11-0012.

Me datë 12 qershor 2012, i autorizuari i paditësve ka parashtruar kundërshtim me të cilin e kundërshton bartjen e lëndën në DHPGJS, sepse aktgjykimi i shkallës së parë duhet të konsiderohet si aktgjykim i rëndësishëm, i pavarur, kryesor gjegjësisht substancial sepse gjykata ka vendos sipas kompetencës ekzistuese në mënyrë meritore ku paditësit janë ligjërisht gjyqëfitues. Tutje thekson se aktgjykimi është marrë para se të hyjë në fuqi ligji 04/L-033 dt. 01.01.2012, dhe në këto rrethana Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut në Prizren është dashur të kenë kompetencë lëndore. Në fund kërkon nga DHPGJS që të aprovoj kundërshtimin e parashtruar dhe të merr vendim që të kthej të gjitha shkresat dhe dokumentet tek Gjykata Komunale dhe tek ajo e Qarkut në Prizren për tu përfunduar lënda.

Me datë 06 shtator 2016, gjyqtari i çështjes SCA-11-0012 lëshon urdhër për Zyrën e Regjistrimit që lëndën ta regjistroj për Kolegjin e Apelit, dhe lënda merr numrin AC-II-16-0009.

Me datë 25 korrik 2019, paditësit dorëzojnë në DHPGJS një parashtresë me të cilën kërkojnë caktimin e masës së përkohshme të sigurisë. Në parashtresë paditësit pohojnë se lënda është përafërsisht 10 vite pranë DHPGJS dhe sipas disa burimeve të besueshme paditësit kanë informacione se i padituri dëshiron që ti shesë konkretisht tenton që ngastrat kadastrale ti shes personave të tretë, me të cilin veprim do të shkaktohej dëm i menjëhershëm dhe i riparueshëm ndaj

paditësve. Andaj paditësit i propozojnë gjykatës që të lëshon vendim për caktimin e masës së sigurisë me të cilin do të ndalohet të paditurës AKP që ti tjetërsoj ngastrat kadastrale nr. 339/2 në sipërfaqe prej 0.67,32 m², ngastrën kadastrale nr. 3338 me sipërfaqe prej 0.04,45 m², ngastrën kadastrale nr 3314 në sipërfaqe prej 0.11,85 m², ngastrën kadastrale nr. 3315 në sipërfaqe prej .09,14 m² të gjitha ZK K, deri në zgjidhjen e plotfuqishme të kontestit gjyqësor në lidhje me këtë çështje.

Me datë 16 gusht 2019, AKP dorëzon në DHPGJS një parashtresë me të cilën i përgjigjet kërkesës për aprovimin e masës së përkohshme të sigurisë së paditësve. AKP e kundërshton në tërësi propozimin për aprovimin e urdhrin paraprak, pasi që paditësit këtë propozim nuk e kanë mbështetur me prova relevante dhe të besueshme. AKP cek nenet 61.1 dhe 61.2 të Ligjit 06/L-086 për DHPGJS me të cilën parashihet se në cilat raste mund të aprovohet kërkesa për urdhër paraprakë gjyqësor. Tutje AKP pohon se paditësit që kërkojnë aprovimin e masës së sigurisë duhet që të dorëzojë me dëshmi se ekziston e drejta (në këtë rast e pronësisë) dhe se kjo e drejtë mund që të dëmtohet në mënyrë të riparueshme nëse nuk miratohet kërkesa për masë sigurie. AKP njofton se lidhur me parcelat P-71813037-03314-0 dhe P-71813037-03315-0, këto parcela janë përfshirë në shitje në NSH DLB Lavërtaria-Blegtoria-Tokë Bujqësore në K-2, dhe sipas procedurave të parapara prona është shitur në shitje SHAL 42 njësia 50 dhe kontrata e shitjes i është dorëzuar blerësit me datë 23.01.2019, ndërsa parcela P-71813037-03339-2 sipas informacioneve nga Zyra Kadastrale në Prizren parcela 3339-2 është e regjistruar në emër të pronarit privat A.H. . Tutje AKP pohon se NSH KBI nuk ka legjitimacion pasiv për procedim të çështjes gjyqësore, pasi që pronat kontestuese në fjalë tashmë i kanë kaluar personave të tretë dhe nuk ekziston më objekt i shqyrtimit të masës së sigurisë lidhur me këto parcela, prandaj nuk mund të konstatohet se ekziston rreziku që paditësit nga ana e të paditurës ti shkaktohet ndonjë dëm i riparueshëm. AKP thekson se nuk është plotësuar as edhe kushti tjetër ligjor për lëshimin e masës së sigurisë, fomis boni iuris (mundësia se e drejta ekziston) dhe nga kjo arsye edhe kërkesa duhet refuzuar si jo e bazuar. AKP i propozon DHPGJS që të nxjerrë Aktvendim me të

cilin e refuzon si të pabazuar në ligj kërkesën e paditësve për lëshimin e masës së sigurisë lidhur me parcelat kadastrale të cekura.

Përgjigjes ia ka bashkangjitur edhe kontratën e shitjes së datës 23.01.2019 dhe Vendimin e Bordit për aprovimin e shitjes nr.BD-120-4-SHAL 48 Neni 14 2 (a) aprovimet.

Me datë 29 gusht 2019, paditësit paraqesin përgjigjen e tyre në ankesat e të paditurave, me të cilën qëndrojnë pranë pretendimeve të mëhershme të tyre. Paditësit pohojnë se të paditurat nuk e kanë marrë parasysh nenin 60 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve se nëse njëra nga palët në kontratë me anë të kërcënimit ose forcës ka shkaktuar frikë të arsyeshme tek pala tjetër dhe se kjo e fundit për këtë arsye është pajtuar për arritje të kësaj kontrate atëherë zhvlerësimi i asaj kontrate mund të kërkohej. Pra të gjitha marrëveshjes e arritura nën presionin e frikës janë absolutisht të pavlefshme qysh në fillimet e tyre, prandaj padia për zhvlerësimin e një kontrate të tillë nuk mund të përshkruhet asnjëherë, as nuk mund të bëhet e plotfuqishme. Paditësit kërkojnë nga Kolegji i Apelit që të refuzoj ankesat si të pabazuara dhe të vërtetoj Aktgjykimin e shkallës së parë si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Juridiksioni i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme është i rregulluar me nenin 5 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kolegji i Apelit konstaton se kjo padi nuk ishte e referuar nga Dhoma e Posaçme asnjëherë, dhe rrjedhimisht kjo gjykatë kishte vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë në zbatim në Dhomën e Posaçme, dhe në kundërshtim me nenin 182, paragrafi 2, pika (f) e LPK-së.

Meqenëse lënda në fjalë ka pasur të bëj me një ndërmarrje shoqërore, KBI Lavërtaria-Blegtoria, me të cilën ka administruar AKM tani Agjencia Kosovare e Privatizimit, sipas nenit 4.1 (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 datë 13 qershor 2002 (e ndryshuar me Rregulloret nr. 2008/04 dhe 2008/19), ishte nën juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme, tani nën juridiksionin ekskluziv të Dhomës së Posaçme (neni 5.1.5 të Ligjit për nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme).

Lënda nuk ishte referuar nga Dhoma e Posaçme tek Gjykata Komunale në Prizren, andaj përfundimisht Gjykata Komunale nuk kishte juridiksion mbi lëndën

Kjo gjykatë ka qenë e obliguar që në bazë të nenit 17, paragrafi 1 i LPK-së, ex officio të trajtoj nëse është kompetente për të gjykuar rastin e parashtruar para saj ose jo. Në këtë mënyrë, në zbatimin e procedurave gjatë vendimmarrjes, kjo gjykatë ka marrë Aktgjykimin e kundërshtuar, me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

Për arsyet e lartpërmendura, Kolegji i Apelit, nuk mund të vërtetoj asnjë vendim me shkelje të tilla procedurale, andaj është e obliguar që të (anuloj) shpallë Aktgjykimin e kundërshtuar pa efekt juridik.

Në bazë të nenit 5, paragrafi 7 i LDHGJS-së, as Dhoma e Posaçme e as Kolegjet apo gjyqtarët e saj, nuk do të kenë asnjë autoritet, për t'i referuar ndonjë kërkesë, lëndë, procedurë, apo rast specifik që është kompetencë primare e tyre, tek gjykatat e tjera në Kosovë.

Për këtë arsye, duke mos paragjykuar epilogun përfundimtar të kësaj padie, Kolegji i Apelit lëndën e dërgon në gjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së.

Gjithashtu, Kolegji i Apelit vendosi që edhe masën e sigurisë të dërgojë në shkallë të parë për vendosje.

Sipas neni 61. 5 i Ligjit thotë: "*Vendimi mbi lejimin e mjetit juridik, masës së sigurisë për një palë është i detyrueshëm për të gjitha palët dhe kundër tij mund të parashtrohet ankesë menjëherë në Kolegjin e Apelit*".

Nga kjo dispozitë shihet qartë se propozimi për urdhrin paraprak gjyqësor nuk mund të parashtrohet kur lënda është në pritje në fazën e apelit, sepse ligji e pranon ankesën kundër vendimit mbi dhënien e masës së sigurisë.

Kjo do të thotë se masa e sigurisë duhet të parashtrohet në shkallën e parë për arsye të respektimit të parimit të dyshkallësh.

Andaj me sa u tha e në bazë të nenit 9.10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore sepse plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së i cili ka hyrë në fuqi më 27.03.2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive në lëndët në pritje.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 26/09/2019.

Ilmi B.mi, Gjyqtar kryesues

URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT:

Ju lutem dërgojeni këtë Aktvendim tek:

- Palët,

Gjykatës Themelore , Prizren

Ilmi Bajramimi, Gjyqtar Kryesues
